REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2071/1 Prot.

Poliçan , më 26.08.2026

VENDIM

Nr64 Datë21.08.2026

PËR

SHPREHJEN E MENDIMIT DHE TË QËNDRIMIT INSTITUCIONAL TË KËSHILLIT BASHKIAK POLIÇAN MBI PROPOZIMIN PËR SHKRIRJEN E BASHKISË POLIÇAN DHE BASHKIMIT ME BASHKINË BERAT, NË KUADËR TË REFORMËS ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE 2.0

Këshilli Bashkiak Poliçan, në mbledhjen e datës 21.08.2026, në zbatim të nenit 13 , nenit 108 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , neni 2 pikat, 2, 6, 10 dhe 12, neni 4 pika 1 , nenit 86, 89, 90, 93 të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", nenit 4 pika 3 , nenit 5 të Kartës Evropiane të Vetqeverisjes Vendore , Parimit të subsidiaritetit dhe Autonomisë Vendore pasi shqyrtoi relacionin shpjegues për projekt-ligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e shqipërisë" sipas Raportit Përfundimtar "Reforma Administrativo-Territoriale 2.0 – Riorganizimi i qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, u njoh me procesverbalet e dëgjesave me komunitetin dhe raportin finalë të përmbledhur të dëgjesave , mendimeve , qëndrimeve të dala nga konsultimet me përfaqësues të komunitetit të njësisë administrative Poliçan , Vërtop, Tërpan ,

VENDOSI: :

1. Këshilli Bashkiak Poliçan shpreh **mendimin e tij KUNDRA shkrirjes së Bashkisë Poliçan dhe shpreh kundërshtimin institucional ndaj çdo propozimi për bashkimin e Bashkisë Poliçan me Bashkinë Berat bazuar në :**
   a) indeksin e funksionalitetit real të Bashkisë Poliçan;
   b) kapaciteti financiar dhe administrativ ekzistues;
   c) mungesa e një risku financiar nga detyrimet e prapambetura;
   ç) identiteti historik, urban dhe industrial i Poliçanit;
   d) konfigurimi i veçantë territorial dhe malor;
   dh) koha reale e aksesit në shërbime;

e) lidhjet sociale, ekonomike dhe territoriale të komunitetit;
ë) ruajtja e afërsisë së shërbimeve me qytetarin;
f) ndikimi që shkrirja do të kishte në zhvillimin ekonomik, social dhe demografik të territorit.

2. Këshilli Bashkiak kërkon që Bashkia Poliçan të trajtohet si **rast i veçantë** në procesin e reformës administrativo-territoriale dhe të ruajë statusin e saj si njësi e veçantë e vetëqeverisjes vendore.

3. Këshilli Bashkiak Poliçan vlerëson se bashkimi i Bashkisë Poliçan me Bashkinë Berat, në kuadër të Reformës Administrativo-Territoriale 2.0, **nuk është i justifikuar nga treguesit financiar-ekonomikë, demografik, historikë dhe sociale të territorit të Bashkisë Poliçanit** pasi:

- Treguesit si potenciali i ulët ekonomik dhe demografikë i popullsisë nuk mund të përdoren si elemente bazë për shkrirjen e bashkisë Poliçan pasi kjo bashki është një bashki me indeks funksional me IFB 52.7 pikë ,e katërta në rang qarku dhe e 35/61 në rang vendi duke lënë pas 26 bashki të tjeta me indeks funksional më të ulët . Vetë projekt-ligji dhe Raporti Përfundimtar përcakton se reforma duhet të synojë bashki funksionale, ruajtjen e identitetit lokal dhe ekuilibrin midis efikasitetit dhe afërsisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Për rrjedhojë, bazuar në **vlerësimin tërësor social , identiteti dhe vlerësimin individual të funksionalitetit të saj**, shprehim mendimin se jemi kundra ndryshimit të statusit të Bashkisë Poliçan nga bashki në Qytet të bashkisë Berat.

- Sipas të dhënave të relacionit shpjegues dhe raportit, Bashkia Poliçan rezulton me tregues **IFB: 52,7**; **IPE: 18,9**; **IMU: 24,3**.Në tabelën e profilit të bashkive të Qarkut Berat, Poliçani ka IFB 52,7, ndërkohë që Skrapari rezulton me 48,2.Këshilli Bashkiak vlerëson se një rezultat i tillë nuk mund të përdoret si fakt se Bashkia Poliçan nuk ka kapacitetin për të funksionuar si njësi më vete, pasi nuk jemi në listën e bashkive me autonomia fiskale të ulët, kemi mbulimi funksional, efiçencë e stafit dhe nuk kemi risk financiar mbi detyrimet e prapambetura pasi në tabelën përkatëse Poliçani rezulton me 1,7% të barrës së detyrimeve të prapambetura, ndërkohë që disa bashki të tjera paraqiten me nivele shumë më të larta.Për këtë arsye, Këshilli Bashkiak shpreh mendimin kundra shkrirjes së bashkisë dhe kundërshton ndryshimin statusit të Bashkisë Poliçan nga bashki në Qytet.

- Projekt-ligji dhe Raporti përcakton Beratin si njësinë ankoruese të Poliçanit dhe jep një kohë udhëtimi prej **38,7 minutash**.Këshilli Bashkiak Poliçan kundërshton bashkimin me Bashkinë Berat bazuar në vlerësimin e treguesve si: relievi malor dhe i thyer; gjendja dhe konfigurimin e rrjetit rrugor; kohën reale të aksesimit të shërbimeve; lidhjet sociale dhe ekonomike të komunitetit;shpërndarjen territoriale të popullsisë; funksionimin real të qytetit të Poliçanit si qendër urbane dhe administrative.

- Këshilli Bashkiak vlerëson se Poliçani përfaqëson një qendër urbane të krijuar në mënyrë të veçantë, me një histori të lidhur ngushtë me industrinë strategjike ushtarake të Shqipërisë. Qyteti u zhvillua në funksion të Kombinatit Mekanik të Poliçanit, i themeluar në vitin 1962, dhe se zhvillimi urban, ekonomik dhe social i qytetit është i lidhur ngushtë me këtë histori industriale. Qyteti nuk u zhvillua rastësisht rreth një aktiviteti ekonomik; ai u krijua dhe u organizua si qendër urbane në funksion të një industrie strategjike shtetërore.Për këtë arsye, Poliçani duhet të vlerësohet përmes treguesve si identitetit urban, historik, industrial, social dhe territorial. Poliçani përfaqëson një rast të veçantë në historinë urbane dhe trashgimisë industriale shqiptare. Në këtë reforme territorial përveç të tjerave duhet të trajtohet si një qytet me status të veçantë, duke marrë në konsideratë identitetin, historinë, kulturën, distancën dhe kohezionin territorial e social.Këshilli Bashkiak vlerëson se sikurse klasifikimi i bashkive minoritare edhe bashkia Poliçan përbën një rast që meriton vlerësim të veçantë në këtë reformë për shkak të:

- Historisë së veçantë të krijimit të qytetit dhe identitetit industrial;
- Rolit historik të industrisë së tij;
- Karakterit territorial dhe malor;
- Ekzistencës së një qendre urbane të konsoliduar;
- Lidhjeve sociale dhe komunitare të krijuara ndër vite.

4. Të pranishëm në mbledhje ishin 15 këshilltarë , të cilët shprehen mendimin unanimisht me 15 (pesëmbëdhjetë vota) KUNDRA shkrirjes së bashkisë Poliçan dhe KUNDRA bashkimit me Bashkinë Berat .

5. Për ndjekjen dhe zbatimin e proçedurave të mëtejshme për përcjelljen pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale; Këshillit të Ministrave;Ministrisë së shtetit ,Prefektit të Qarkut Berat; të qëndrimit institucional , mendimit të këshillit bashkiak së bashku me relacionin argumentues dhe dokumentacionin mbështetës,të Këshillit Bashkiak Poliçan në të gjitha fazat e procesit të Reformës Administrativo-Territoriale, ngarkohet komisioni i ngarkuar nga këshilli, Kryetari i Bashkisë Poliçan dhe administrata e Bashkisë.

PËR KËSHILLIN BASHKIAK POLIÇAN :

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

MIMOZA LULAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN

ANËTARËT E KËSHILLIT BASHKIAK :

1. Astrit Hoxha **Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak**
2. Ariana Hasanaj **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
3. Sidorela Saliasi **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
4. Refat Shahini **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
5. Ermira Taho **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
6. Fabrie Çela **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
7. Hejdi Braçaj **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
8. Elfete Qerimi **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
9. Adrianke Sadiu **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
10. Haki Nesa **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
11. Ibrahim Shehu **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
12. Xhuna Agapi **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
13. Hajredin Daiu **Anëtar i Këshillit Bashkiak**
14. Vamik Alpion **Anëtar i Këshillit Bashkiak**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POLICAN